

VENDIM
Nr. 37, datë 31.3.2016

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-s, “GJENDJA E SEKTORIT TË
ENERGJISË DHE VEPRIMTARIA E ERE-s GJATË VITIT 2015”**

Në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 21, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 31.3.2016, mbasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s, “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2015”, të paraqitur nga kryetari i ERE-s,

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor të ERE-s, “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2015”, që do t’i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (raporti bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti